



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0031

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Isa Hasani, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Marisa” SH.P.K., kundër Njoftimit të kontratës të KOMUNA E GJAKOVËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Re-Tender-Rehabilitimi dhe ndertimi i hapësirave publike” me numër të prokurimit 632-23-13225-5-1-1, me 28/03/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE “Marisa SH.P.K.” me nr. 2024/0031, e datës 09/01/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Re-Tender-Rehabilitimi dhe ndertimi i hapësirave publike” me numër të prokurimit 632-23-13225-5-1-1.
2. Autoriteti kontraktues, detyrohet të përmirësojë Dosjen e Tenderit/ Njoftim për Kontratë B05, sipas konstatimit të parë dhe dytë të Raportit ekspertit shqyrtues nr; 2024/0031, të mbështetur nga Paneli Shqyrtues dhe të zgjasë afatin për ofertim sipas ligjit.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 24.11.2023, Komuna e Gjakovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Re-Tender-Rehabilitimi dhe ndertimi i hapësirave

publike” me numër të prokurimit 632-23-13225-5-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës Punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 1,570,000.00

Me 22.12.2023, OE “Marisa” SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 27.12.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 09.01.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Marisa” SH.P.K., me nr. 2024/0031 lidhur me aktivitetin “Re-Tender-Rehabilitimi dhe ndërtimi i hapësirave publike” me numër të prokurimit 632-23-13225-5-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE “Marisa” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Ankuesi pretendon se Komuna e Gjakovës ka publikuar tenderin me titull: "Re-Tender Rehabilitimi dhe ndërtimi i hapësirave publike" ku gjate analizës se bere nga ne kemi pare qe ky tenderë është favorizues ku kushtet dhe kriteret për aplikim janë diskriminuese se dihet shumë qarte se vendi ynë nuk është prodhues i shumicës se këtyre produkteve por këto produkte duhet te transportohen nga Vendet e ndryshëm Siç është Bullgaria e cila ka një kompani qe bën prodhimin e shumicës se këtyre produkteve, Autoriteti Kontraktues me këto kriteret ka diskriminuar Konkurrencën edhe ja përgatit tenderin një kompanie te caktuar.

Pretendimi i parë (I) - Ankuesi pretendon se “ Sipas pjesëmarrjes se tenderit shihet shumë qartë se te gjitha kushtet dhe kriteret për kontratë si dhe paramasa është e përgatitur për kompaninë siç shihet edhe ne procesin e hapjes se këtij tenderi qe tani me është ri tenderuar. Shihet shumë qartë se AK ka përgatitje ku ulësja ka dimensione dhe peshë te caktuar pse duhet cekur Pesha, dhe standardi i një kompani te caktuar. sipas nenit 28 duhet te jete ekuivalente Neni 28 pika 2. Autoriteti kontraktues do ti përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe te drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartoj specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operator ekonomik. Autoriteti Kontraktues duhet te ju përmbahet Standardeve te Kosovës siç thotë neni 28 pika 4 . Autoritetet kontraktuese do të formulojnë specifikimet teknike duke iu referuar (i) një standardi të Kosovës që implementon një standard Evropian, (ti) një standardi Evropian. (iii) një miratimi teknik Evropian (iv) një specifikimi të përbashkët teknik, (v) një standardi ndërkombëtar apo (v) çfarëdo referimi tjetër teknik të nxjerr nga organet Evropiane për standardizim. Këto Standarde te Produkteve nuk janë te aplikueshme ne vendin tone për arsyeje se vendi jone nuk ka trup certifikues por këtë certifikate blihen si produkt jo qe tregon cilësinë e Produktit. Ulësja është pika me diskriminuese ne këtë dosje tenderit për arsyeje se kjo është shumë e kushtueshme për tu sjell ne vend dhe shumë qartë shihet se këtë lloj te fontanës e ka kompania siç shihet edhe ne procesin e hapjes se këtij tenderi qe tani me është ri tenderuar. Ne e morëm si shembull ulësen kur e përmendem me lart për arsyeje se ka shumë produkte qe kanë te njëjta specifika me dimensione, pesha dhe standardi ju si Autoritet Kontraktues duhet te i

eliminoni këto kushte ne dosjen e tenderit pasi qe janë favorizuese dhe shihet qartë pas aplikim ne tender dhe procesit te hapjes. Kushtet dhe Kriteret e kontratës te prezantuar me lart janë Favorizuese dhe diskriminuese pasi qe na pamundëson pjesëmarrjen ne këtë tender për arsyeje se kushtet e vendosura nga AK Komuna e Gjakovës janë te dëmshme dhe te kundërligjshme për favorizim te OE.”

Pretendimi i dytë (I) - Ankuesi pretendon se “AK ka parapare tek Kërkesat mbi mundësinë teknike dhe ose profesionale 9.1 dhe 9.2 se “Operatori ekonomik së bashku me tenderin duhet te dorëzoj mostrat për produktet e specifikuar në para masë në pozicionet A (1, 2, 3, 4, 5, 6, 26, 65, 69, 91, 94, 193,197), këto produkte duhet ti këtë të gatshme për prezantim, në të kundërtën oferta do të refuzohet”. Këto mostra te cilat i kërkon AK është diskriminuese pasi qe këto produkte nuk prodhohen ne vendin tone me këtë teknik, AK dëshmon se ka favorizime për këtë tender ku mostrat janë te madhësive te ndryshme duhet makineri e veçantë për bartjen e tyre.”

Pretendimi i tretë (I) - Ankuesi pretendon se “Produktet qe janë te kërkuar ne dosjen e tenderit nuk janë për mostra këto mund te behën me katalogë, mostrat kane shpenzime dhe dëmtojnë OE. Me qene Tenderi për produkte te mjekësi apo produkte që kanë ndikim drejtpërdrejtë në jetën e qytetareve dhe paraqesin rrezik atëherë ky term duhet te aplikohet për të sjell mostra e jo për ulëse, llampa elektrike, shtylla te parkingjeve. Autoriteti Kontraktues duhet qe ti heq këto kushte dhe kriteret dhe të lejoj që të marrin pjesë të gjithë OE e jo të përgatit Dosjen e tenderit për një OE të caktuar ku sipas kriterëve thuajse e dimë edhe OE se për ke është i përgatitur pasi që kemi parë këto kushte dhe kriteret të një Autoriteti Kontraktues tjetër. Autoriteti Kontraktues duhet te veproj sipas nenit 6 dhe nenit 7 dhe 28 të LPP-së. Kërkojmë nga AK Komuna e Gjakovës qe te bejnë ndryshimin e kushteve dhe kriterëve te dosjes se tenderit ku te na lejohet qe te jemi edhe ne pjesëmarrës pasi qe me këto kushte është e pamundur pasi qe ka bllokuar konkurrencën dhe AK është ne kundërshtim me nenin 28 LPP-se. Kërkojmë nga OSHP qe te kerkoj nga Komuna e Gjakovës qe te bej edhe ndryshimin e Paramases pasi qe paramasa është identike me një AK tjetër, Asnjë Autoritete Kontraktues nuk mund ti ketë Kërkesat e njëjta dhe secila duhet te jete e hartuar sipas nevojës se AK, gjithashtu tek paramasa shihet shume qartë se ka gabime tek peshimi ku nuk është ndarë ne përqindje secila pjese por është lenë hapësirë për manovrimet te çmimeve dhe me atë ne kuptojmë se autoriteti Kontraktues mund te porosit një produkt i cili ka çmimin me te larte për 70% t kontratës gjithashtu mund te ndodh edhe tek pjesa tjetër e Cila është ndare me 30% te çmimit te peshuar. Ne asnjë pike te Paramases nuk është cekur fjala Ekuivalente (ose e ngjashme) por edhe nëse ceket kjo fjale nuk mund te behet pasi është përmendur dimensionet te caktuar për produkte p.sh. Fontana ka te cekur edhe peshën.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE “Marisa” SH.P.K. konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, 7, 28, 37, 56, 60 dhe 69 të LPP duke kërkuar nga Paneli Shqyrtues që të aprovohet ankesa si e bazuar dhe të ndryshohen specifikacionet favorizuese të vendosura nga AK – Komuna e Gjakovës.

Përgjigje e AK - ndaj kërkesës për rishqyrtim të OE “Marisa” SH.P.K.

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim pasi që pretendimet janë të pa bazuara dhe AK nuk ka vendosur limit fiks për këto kriteret dhe është AK që vendos kriteret dhe specifikat që mendon se janë të domosdoshme për kryerjen më sukses të një aktiviteti. Si dhe AK ka vepruar konform nenit 37 paragrafi 2 dhe 6 të Rregullores për Prokurim Publik.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 11.01.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2024/0031 ndërsa me datë 22.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0031 me rekomandimet si në vijim: “Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti

shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimit për kontratë dhe nëse AK më tutje ka interes, aktivitetin e prokurimit ta ritenderojë.”

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është deklaruar se nuk pajtohet rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues duke theksuar “Pretendimi nr.1 AK nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, shprehja minimale nuk është element kushtëzues, AK ka paraparë që produktet të mos kenë dimensione nën minimumin e kërkuar që pengon realizimin e projektit. sa i përket peshës të ulëseve dhe fontanës AK vlerëson që pesha e përcakton kualitetin dhe qëndrueshmërinë e produktit. Pretendimi nr. 2 AK ka kërkuar që OE të prezantojnë mostrat para hapjes të tenderit është bazuar në RRPP 001/2022 f 71 neni 37 pika 37.6. Pretendimi nr. 3 AK mënon që OE ankues nuk ka mundur të precizoj gjetje të gabimeve në paramas, AK pajtohet me mendimin e ekspertit, ndërsa OE është pajtuar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues duke theksuar se “Kërkojmë që të ndryshohen kriteret e kontratës, dhe të thirren në seancë njësi kërkesë e AK Komuna e Gjakovës mbi vendosjen e këtyre specifikacioneve favorizuese për një kompani të caktuar siç janë paraqitur të gjitha dëshmitë në Ankese.”

Vlerësimi i eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0031, të pretendimeve ankimore të OE “Marisa” SH.P.K. ankues, si në vijim;

Konstatimi i parë (I) – Eksperti shqyrtues sqaron se “Pas analizimit të dosjes së të tenderit, në veçanti paramasës, kemi gjetur se AK në shumë pozicione ka kërkuar dimensione specifike, mirëpo duke vendosur në fund të kërkesës dimensione “minimale”. Sipas mendimit të ekspertit shprehja “minimale” lenë mundësinë që OE-të të ofrojnë produkte me dimensione më të mëdha, mirëpo në këtë rast sipas mendimit tonë OE-të mund të ofrojnë produkte me dimensione dukshëm më të larta se ato të kërkuara e çka potencialisht mund të paraqes pengesa për realizim të mirë të prokurimit për AK-në, andaj vlerësojmë se për pozicionet siç janë ulëset, fontana etj, të caktohet një tolerancë e lejuar nga kërkesa e AK-së, p.sh. toleranca +10%. Ndërsa për pozicionet ku AK ka kërkuar peshë specifike/fikse, si p.sh. ulëse me peshë 1000kg, apo fontana me peshë 300kg, [për mendimin tonë janë komplet të panevojshme, pasi pesha e fontanës dhe ulëses nuk është kurrfarë njësi matëse apo parametër I cili dëshmon kualitetin e produktit që ofrohet, dhe si e tillë kjo kërkesë konsiderojmë se duhet të hiqet në tërësi nga kërkesat e specifikacionit Teknik. Bazuar në këto që u thanë më lart vlerësojmë se pretendimet ankimore janë të bazuara.”

Konstatimi i dytë (II) – Eksperti shqyrtues sqaron se “Pas analizimit të dosjes së tenderit, kemi gjetur se AK në dosje të tenderit ka kërkuar :“Operatori ekonomik së bashku me tenderin duhet të dorëzojë mostrat për produktet e specifikuar në paramasë në pozicionet A (1, 2, 3, 4, 5, 6, 26, 65, 69, 91, 94, 193, 197). (këto produkte duhet të ketë të gatshme për prezantim, në të kundërtën oferta do të refuzohet).” Shumë prej këtyre pozicioneve kanë të bëjnë me pesha të rënda, deri në 1000kg (sipas kërkesës së AK-së), andaj pajtohemi dhe ndajmë mendimin e njëjtë sikurse OE ankues që kjo është kërkesë e cila do të sillte shpenzime të larta dhe pa nevojshme për OE-të ofertues. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimet ankimore janë të bazuara.”

Konstatimi i tretë (III) – Eksperti shqyrtues sqaron se “OE ankues po ashtu pretendon se paramasa ka gabime dhe është paramasë e njëjtë me atë të një autoriteti kontraktues tjetër, dhe është e pamundur që dy Autoritete kontraktuese të kenë nevojat identike. Megjithatë OE ankues nuk jep sqarime të mëtutjeshme se cilat janë ato gabime që sipas tij gjenden në paramasë, apo në çfarë mënyrë ato mund të rregullohen, andaj edhe nuk mund të japim përgjigje konkrete në këtë pretendim ankimorë.”

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues është i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik dhe përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, sipas të cilit pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik ankues janë konstatuar si të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa duhet të aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur që duhet të përmirësohet Dosja e tenderit/ Njoftimin për Kontratë e Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit “Re-Tender-Rehabilitimi dhe ndërtimi i hapësirave publike” me numër të prokurimit 632-23-13225-5-1-1, pasi që është vlerësuar se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore.

Paneli Shqyrtues vlerëson se duhet përmirësuar kriteret e Dosjes tenderit/Njoftimit për Kontratë, për aktivitetin e prokurimit të lartcekur për shkak të kriterëve të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat ligjore andaj obligohet Autoriteti Kontraktues të bëjnë përmirësimet e kriterëve të Dosjes tenderit/Njoftimit për Kontratë, sipas konstatimeve numër një (1) dhe dy (2) të Raportit ekspertit shqyrtues, e të cilat konstatime i ka mbështetur Paneli shqyrtues.

Paneli shqyrtues konstaton se përmirësimi i kriterëve të Dosjes së tenderit/Njoftimit për Kontratë, do të ofrohej mundësi më të madhe për pjesëmarrje të OE-ve në aktivitetin e prokurimit, duke mos dëmtuar apo duke mos ulur cilësinë e produkteve të kërkuara. PSH konsideron se gjithë AK-të duhet të kenë kujdes të shtuar në mënyrë që kriteret e përzgjedhjes nuk do të duhet të jenë padrejtësisht të rrepta që qojnë deri tek diskriminimi dhe kufizimi i konkurrencës, si dhe për të siguruar konkurrencë sa më të madhe të mundur, pa rrezikuar kontraktimin e kompanive joprofesionale si dhe me qëllimin e kuptueshëm për të filtruar dhe përjashtuar kompanitë e paqëndrueshme të cilat nuk mund që të zbatojnë kontratën specifike, kështu që kriteret e përzgjedhjes duhet të përmbushin objektivin e saj dhe praktikisht të filtrojnë kompanitë e paqëndrueshme, në raport me vëllimin dhe kompleksitetin e punëve të parapara në aktivitet, por jo në

masë që kriteret e vendosura të shpijnë në diskriminim dhe në paqëndrueshmëri dhe kundërshtim me dispozitat ligjore.

Paneli shqyrtues konstaton se kthimi i një aktiviteti të prokurimit për përmirësim të Dosjes së Tenderit, me fakte dhe prova dhe/ose me bazë ligjore, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Sido që të jetë për secilën kërkesë të vendosur nga AK në Dosjen e Tenderit, duke u bazuar në nenin 24, paragrafi 2 i LPP, Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj. Po ashtu edhe sipas nenit 51, paragrafi 3 i LPP, AK duhet që gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - Marisa SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: